



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Nr. 47 Prot.

Tiranë, më 14.05. 2026

VENDIM

Nr. 102, Datë 22.04.2026

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit (në vijim KMK) në mbledhjen e tij të datës 22.04.2026 ku morën pjesë:

- | | |
|-----------------------|-----------------|
| - Znj. Ersida Teliti | Zëvendëskryetar |
| - Z. Klodian Mene | Anëtar |
| - Z. Gentjan Thoma | Anëtar |
| - Znj. Anairda Arizaj | Anëtare |

vijoi shqyrtimin e ankesës së konsumatores R.A kundrejt shoqërisë “Instituti Profesional ATC” dhe pasi dëgjoji informacionin e përgatitur nga Sekretariati teknik në lidhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion të tij,

VËREN :

- Rrethanat e çështjes

Pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit është paraqitur me e-mailin e datës 11.09.2025 ankesa e konsumatores R.A kundrejt shoqërisë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k (administruar pranë KMK-së me numër protokolli nr.50, datë 11.09.2025).

Ankesa e paraqitur pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit është si vijon:

Sipas pretendimeve të konsumatores, më datë 15.07.2025 është nënshkruar një kontratë për ndjekjen e një kursi pranë shoqërisë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k duke paguar edhe shumën prej 5,000 lekësh (si kapar). Ankesa konsiston në pretendimin se, kursi nuk filloi dhe nuk iu ofrua asnjë shërbim. Më pas, për arsye personale konsumatorja vendosi të mos e ndjekë kursin duke kërkuar kthimin e shumës së paguar në datën 31.07.2025. Sipas pretendimeve të konsumatores, më datë 13.08.2025 ka dorëzuar një kërkesë me shkrim për anulimin e kontratës dhe kthimin e shumës së paguar. Më pas, më datë 03.09.2025, shoqëria “Instituti Profesional ATC” i ka kthyer përgjigje nëpërmjet aplikacionit “WhatsApp”, duke i ofruar vetëm mundësinë e transferimit të kursit për periudhën shkurt/mars, por ky propozim nuk është pranuar nga konsumatorja. Konsumatorja ka kthyer përgjigje me shkrim duke insistuar për anulimin e kontratës dhe rimbursimin, por nuk ka marrë asnjë zgjidhje.

Pas administrimit të ankesës, KMK-ja me shkresën nr.50/1, datë 18.09.2025, ia ka dërguar për kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve, bazuar në VKM-në nr.1089, datë 24.10.2020 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, si dhe për përcaktimin e kriterëve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”, ku është parashikuar se Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe ka si fushë përgjegjësie zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, të tjera nga ato që lidhen me shërbimet për interes publik. Me e-mailin e datës 10.11.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve i ka kthyer përgjigje komisionit se pasi mori në shqyrtim ankesën nuk ka arritur dot një zgjidhje konkrete mes palëve.

KMK-ja në zbatim të pikës 4, të VKM-së nr.1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”, në mbledhjen e datës 18.12.2025 vendosi trajtimin e saj dhe nisjen e shqyrtimit administrativ, duke njoftuar konsumatoren dhe shoqërinë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k nëpërmjet shkresës nr.50/4, datë 30.12.2025 për fillimin e shqyrtimit administrativ, si dhe detyrimin e palëve për dhënien e një informacioni të plotë dhe sqarues, si dhe çdo dokumentacion tjetër që mund të disponohet në lidhje me çështjen brenda datës 20 janar 2026. Gjithashtu me shkresën nr.50/3, datë 30.12.2025 KMK-ja ka njoftuar shoqërinë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k për fillimin e shqyrtimit administrativ në lidhje me kontratat e lidhura nga kjo shoqëri me konsumatorët (kursantët). Me anë të kësaj shkrese, KMK-ja i kërkoi shoqërisë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k që t’i vendosë në dispozicion dokumentin “Kontratë kursi” (kopje e njehsuar me origjinalin) që kjo shoqëri lidh me kursantët, si dhe të gjithë dokumentacionin shoqërues të kontratës, brenda datës 20 janar 2026. Gjithashtu, nëpërmjet shkresave të sipërcituara, informohej subjekti tregtar që mosdhënia e informacionit të kërkuar në zbatim të nenit 52/1, të ligjit nr.9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar ku parashikohet se: *“Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë e jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji”*, përbën shkelje administrative dhe ndëshkohet me gjobë në bazë të legjislacionit në fuqi. Ndërkohë shkresa nr.50/4, datë 30.12.2025 i është dërguar konsumatores R.A edhe në rrugë elektronike me e-mailin e datës 30.12.2025.

Më pas, nëpërmjet “Lajmërim marrje RR808293973AA” datë 30.12.2025 dhe “Lajmërim marrje RR806983940AA” datë 30.12.2025, të Postës Shqiptare, KMK-ja është njoftuar se zarfat nuk i janë dorëzuar shoqërisë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k (pasi janë kthyer). Për këtë arsye, shkresat janë rinisur përsëri, dhe nëpërmjet “Lajmërim marrje RR803944981AA” datë 12.01.2026 dhe “Lajmërim marrje RR805097569AA” datë 12.01.2026, të Postës Shqiptare, rezulton se zarfat janë marrë në dorëzim nga shoqëria “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k.

Më pas, KMK-ja ka administruar përgjigjen e ardhur vetëm nga konsumatorja R.A, e cila me e-mailin e datës 05.01.2026 ka përcjellë informacionin dhe dokumentacionin provues, si vijon:

- Kontratë kursi datë 15.07.2025 (lidhur ndërmjet shoqërisë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k, përfaqësuar nga Administratori A.Z dhe kursantit R.A), shoqëruar me rregulloren;
- Komunikime në aplikacionin Whatsapp (screenshot);
- Kërkesë datë 13.08.2025 për anulim kontrate dhe kthimin e shumës së paguar.

KMK-ja në mbledhjen e datës 24.02.2026, rimori në shqyrtim ankesën dhe konstatoi se nga ana e shoqërisë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k nuk është sjellë asnjë informacion për sa është kërkuar

nëpërmjet shkresave nr.50/3, datë 30.12.2025 dhe nr.50/4, datë 30.12.2025. Në këto kushte, KMK-ja vendosi t'i rikërkonte informacion shoqërisë "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k.

Me shkresën nr.50/6, datë 10.03.2026 i është ridërguar kërkesa për informacion të plotë sqarues dhe dokumentacion shoqërisë "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k, në lidhje me ankesën e konsumatores R.A, duke kërkuar që informacioni të dërgohet brenda datës 30 mars 2026. Gjithashtu, me shkresën nr.50/7, datë 10.03.2026 i është ridërguar kërkesa për informacion të plotë sqarues shoqërisë "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k, në lidhje me kontratat e lidhura nga kjo shoqëri me konsumatorët (kursantët), duke i kërkuar vënien në dispozicion të dokumentit "Kontratë kursi" (kopje e njehsuar me origjinalin) që shoqëria "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k lidh me kursantët, si dhe gjithë dokumentacionin shoqëruar të kontratës. Nëpërmjet shkresave të sipërcituara, përveç informacionit, informohej shoqëria "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k se, në zbatim të nenit 52/1 të ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar parashikohet se: *"Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë e jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji"* dhe në zbatim të nenit 57, pika 2, gërma "ç", për mosplotësimin të kërkesave të parashikuara në nenin 52/1, subjekti tregtar ndëshkohet me gjobë në masën 300,000 lekë.

Më datë 12.03.2026, nëpërmjet "Lajmërim marrje RR813360211AA" datë 11.03.2026 dhe "Lajmërim marrje RR810473302AA" datë 11.03.2026 të Postës Shqiptare, KMK-ja është njoftuar se zarfat janë marrë në dorëzim nga shoqëria "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k.

- Lidhur me kompetencën lëndore të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit

KMK-ja është krijuar dhe funksionon në përputhje me ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, neni 52 dhe me VKM-në nr.1444, datë 22.10.2008 "Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve" dhe ka si qëllim shqyrtimin e shkeljeve dhe marrjen e masave për zbatimin e dispozitave ligjore.

Së pari, ligji nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, në nenin 2, përcakton që: *"Ky ligj përfshin të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, që kanë të bëjnë me mallrat e konsumatorëve apo shërbime."* dhe:

- në nenin 3, pika 6 parashikohet që: *"Konsumator" është çdo person, i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare "biznesin, zanatin" ose ushtrimin e profesionit."* Konsumatorja R.A ka lidhur një kontratë shërbimi me shoqërinë "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k për të përfutur një shërbimi për plotësimin e nevojave vetjake për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare dhe plotëson kërkesat ligjore për t'u klasifikuar si "konsumator".
- në nenin 3, pika 14 parashikohet që: *"Tregtar" është çdo person fizik ose juridik privat ose publik, i cili vepron për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike, tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin, si dhe cilido, që vepron në emër ose në interes të tregtarit"*. Shoqëria "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k plotëson kërkesat ligjore për t'u klasifikuar si "tregtar", pasi është qendër formimi profesional, i cili vepron për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike dhe/ose tregtinë.

Shoqëria "Instituti Profesional ATC" Sh.p.k është qendër formimi profesional me objekt aktiviteti zhvillimin e kurseve profesionale njëvjeçare, tremujore në disa profile si: shef kuzhine, kuzhinier, pastičer, menaxher marketing & turizmi, grafik dizajner, web dizajner, montazhier, etj.

Pra, kjo është një marrëdhënie midis tregtarit dhe konsumatorëve dhe është brenda fushës së zbatimit të ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, për pasojë çështja është brenda kompetencës lëndore të KMK-së.

Sa më sipër, KMK-ja vlerëson se, shqyrtimi i ankesës së lartpërmendur është në kompetencë të tij.

Së dyti, shoqëria “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë informacion, për sa i është kërkuar nga ana e KMK-së.

Për sa më sipër, KMK-ja mbështetur në nenin 52/1 të Ligjit nr. 9902 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve" i ndryshuar, sipas të cilit: *“Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë dhe jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji”*, konstatoi shkelje të këtij neni, si pasojë e mungesës së dhënies së informacionit të kërkuar nga KMK-ja.

- Lidhur me kompetencën territoriale të Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit

Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit në zbatim të ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, e ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, në këto kushte vlerëson se shqyrtimi i kësaj çështje është në kompetencën territoriale të saj.

KMK-ja, nisur nga ankesa e konsumatores R.A kundrejt shoqërisë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k, në mbledhjen e datës 18.12.2025 vendosi fillimin e hetimit administrativ për shoqërinë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k, por meqenëse në mbledhjen e radhës së komisionit u konstatua se nga ana e shoqërisë nuk ishte dërguar informacioni në lidhje me këtë ankesë dhe në lidhje me kontratat e lidhura nga kjo shoqëri me konsumatorët (kursantët), u vendos që t’i ridërgohen kërkesat për informacion.

KMK-ja në mbledhjen e datës 22.04.2026 konstatoi se deri më këtë datë të zhvillimit të mbledhjes së tij, shoqëria “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë informacion me shkrim, apo ndonjë përgjigje zyrtare, me anë të së cilës për arsye objektive të kërkohej shtyrja e afatit apo të justifikohesh mosdhënia e informacionit.

Ligji nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, në nenin 52/1 ka parashikuar që: *“Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë dhe jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji”*, dhe në zbatim të nenit 57, pika 2, gërma “ç”, për mosplotësimin të kërkesave të parashikuara në nenin 52/1, subjekti tregtar ndëshkohet me gjobë në masën 300,000 lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve në mungesë të dhënies së informacionit nga ana e shoqërisë “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k (megjithëse nëpërmjet “Lajmërim marrje RR803944981AA” datë 12.01.2026, “Lajmërim marrje RR805097569AA” datë 12.01.2026, “Lajmërim marrje RR813360211AA” datë 11.03.2026 dhe “Lajmërim marrje RR810473302AA” datë 11.03.2026 të Postës Shqiptare, zarfat janë marrë në dorëzim nga shoqëria “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k, pra kjo e fundit ka marrë dijeni), KMK-ja mbështetur në nenin 52, nenin 52/1, nenin 57 pikën 2, gërma “ç”,

nenin 58, pikën 2 dhe 3 të Ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar, si dhe në pikën 2, pikën 6 (c) të VKM-së nr.1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”,

VENDOSI:

1. Shoqëria “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k, të gjobitet me shumën 300,000 lekë.
2. Shoqëria “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k, të njoftojë menjëherë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për pagesën e gjobës brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të këtij vendimi.
3. Shoqëria “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k, duhet ta shlyejë gjobën brenda 10 ditëve nga data e marrjes njoftim për vendosjen e saj.
4. Gjoka e vendosur është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyra e përmbartimit, në rast se nuk shlyhet në kohë nga shoqëria “Instituti Profesional ATC” Sh.p.k.
5. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

ZËVENDËSKRYETAR I KOMISIONIT

